

Thirrje për shprehje interesi për trajnues

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare njofton të gjithë të interesuarit se do të përditësojë listën e trajnuesve të jashtëm për aktivitetet e kualifikimit profesional dhe edukimit në vazhdim.

Të interesuarit duhet të plotësojnë dhe dërgojnë në adresën amf@amf.gov.al brenda datës 26 mars 2021, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë për shprehje interesi, në përputhje me aneksin 1 të Rregullores nr.198, datë 29.12.2020 “Për kualifikimin profesional dhe edukimin në vazhdim”;
2. Shtjellim të eksperiencës së fituar në një nga fushat e tregjeve nën mbikëqyrje të Autoritetit;
3. Shtjellim të eksperiencës së mëparshme si trajnues;
4. Jetëshkrim në gjuhën shqipe/ fotokopje të kartës së identitetit (ID).

Shënim: Aplikuesit nuk duhet të kenë qenë subjekt i masave administrative të marra nga Autoriteti.